

TEKSTET PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022

Klasa	Titulli	Lloji i tekstit	Botuesi/ Distributori	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin, në LEKË, Jo më lartë, PA TVSH
10	Histori 10	Digjital	ALBAS	463
10	Qytetari 10	Digjital	ALBAS	308
10	Matematikë 10-11, libri i nxënësit, pjesa I	Jodigjital	BOTIME PEGI	550
10	Biologji 10-11, pjesa I	Jodigjital	BOTIME PEGI	440
10	Kimi 10-11, pjesa I	Jodigjital	BOTIME PEGI	440
10	Fizikë 10-11, libri i nxënësit, pjesa I	Jodigjital	ERIK	298
10	Gjuhë shqipe 10	Jodigjital	FILARA	530
10	Letërsi 10	Jodigjital	FILARA	550
10	Gjeografi 10	Digjital	IDEART	411
10	TIK 10	Digjital	IDEART	430
10	Allegro 1 corso multimediale d'italiano, libro dello studente ed esercizi (gjuhë italiane e dytë, libri i nxënësit dhe fletore pune)	Jodigjital	SIDI GROUP	1214
10	Focus2 B1+ Student's Book (gjuhë angleze e parë, libri i nxënësit)	Jodigjital	UEGEN	757
10	Focus B1+ Workbook (gjuhë angleze e parë, fletore pune)	Jodigjital	UEGEN	530
11	Matematikë 10-11, libri i nxënësit, pjesa II	Jodigjital	BOTIME PEGI	550
11	Kimi 10-11, pjesa II	Jodigjital	BOTIME PEGI	440
11	Gjuha shqipe 11	Digjital	BOTIME PEGI	558
11	Biologji 10-11, pjesa II	Jodigjital	BOTIME PEGI	440
11	Fizikë 10-11, libri i nxënësit, pjesa II	Jodigjital	ERIK	314
11	Letërsia 11	Jodigjital	FILARA	558
11	Historia 11	Jodigjital	FILARA	349
11	Gjeografia 11	Digjital	IDEART	548
11	TIK 11	Digjital	IDEART	264
11	Allegro 2, libro dello studente ed esercizi (gjuha italiane e dytë 11, libri i nxënësit dhe fletore pune)	Jodigjital	SIDI EDUCATION	923
11	Filozofia 11	Digjital	SHBLSH E RE	444

Klasa	Titulli	Lloji i tekstit	Botuesi/ Distributori	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin, në LEKË, Jo më lartë, PA TVSH
11	Focus 3, Student's Book (gjuha angleze e parë 11, libri i nxënësit)	Digjital	UEGEN	798
11	Focus 3, Workbook (gjuha angleze e parë 11, fletore pune)	Digjital	UEGEN	464
12	Gjeografia me zgjedhje 12	Digjital	ALBAS	1006
12	Psikologjia me zgjedhje 12	Digjital	ALBAS	407
12	Sociologjia me zgjedhje 12	Digjital	ALBAS	426
12	Matematika 12, libri i nxënësit	Digjital	BOTIME PEGI	635
12	Ekonomia 12	Digjital	BOTIME PEGI	635
12	Matematika me zgjedhje 12, libri i nxënësit	Digjital	BOTIME PEGI	847
12	Gjuha shqipe 12	Digjital	FILARA	688
12	Letërsia 12	Digjital	FILARA	688
12	Letërsia me zgjedhje 12	Digjital	FILARA	635
12	Historia me zgjedhje 12	Digjital	FILARA	688
12	Fizika me zgjedhje 12, libri i nxënësit	Digjital	MEDIAPRINT	1059
12	Biologjia me zgjedhje 12, libri i nxënësit	Digjital	MEDIAPRINT	1059
12	Kimia me zgjedhje 12, libri i nxënësit	Digjital	MEDIAPRINT	1059
12	Allegro 3, libro dello studente ed esercizi (gjuha italiane e dytë 11, libri i nxënësit dhe fletore pune)	Jodigjital	SIDI EDUCATION	949
12	Teknologjia me zgjedhje 12	Digjital	SHBLSH E RE	466
12	Focus 4, Student's Book (gjuha angleze e parë 12, libri i nxënësit)	Jodigjital	UEGEN	827
12	Focus 4, Workbook (gjuha angleze e parë 12, fletore pune)	Jodigjital	UEGEN	482

Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin, sipas katalogut të teksteve shkollore, i indeksuar me koeficientin e inflacionit + 1,6% sipas INSTAT, është jo më lartë se në tabelë. Çmimet janë në LEKË, PA TVSH.

Baza ligjore për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore:

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 17.6.2020, "Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar".

Urdhri i MASR-së nr. 46, datë 16.3.2021 "Për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të klasave 1, 2, 3, 4, 8,9, 10, 11, 12 të sistemit arsimor parauniversitar për vitin shkollor 2021-2022".

VENDIM
Nr. 486, datë 17.6.2020

PËR SHTYPJEN, BOTIMIN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 e 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton dhe certifikon tekstet shkollore të arsimit parauniversitar, të cilat konkurrojnë, në barazi të plotë, në përzgjedhje nga përdoruesit. Kriteret dhe procedurat e konkurrimit e të përzgjedhjes përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Procesi i shtypjes, botimit, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese. Shtëpitë botuese, të cilat marrin përsipër ta kryejnë këtë proces, paraqesin tekstet, për miratim, në bazë të kriterëve e të procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin. Shpenzimet për tekstet shkollore të dërguara në institucionin arsimor ose Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (në vijim ZVAP) për të konkurruar në përzgjedhjen e tyre, përballohen nga shtëpia botuese.

3. Tekstet shkollore shpërndahen/shiten në mjediset shkollore. Drejtoritë e institucioneve arsimore ofrojnë një ose dy mjedise shkollore, që përdoren nga të gjitha shtëpitë botuese, që lëvrojnë tekste në institucionin arsimor në fjalë.

4. Çmimi i shitjes është ai i vendosur në kopertinën e tekstit shkollor të certifikuar. Çmimet e teksteve shkollore, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, indeksohen çdo vit, në përputhje me rritjen e inflacionit, të publikuar nga INSTAT-i.

5. Tekstet duhet të jenë të pajisura me pullën me hologramë të certifikimit, të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Pulla me hologramë u shitet botuesve nga ministria përgjegjëse për arsimin, kundrejt pagesës. Tekstet, që tregtohen pa këtë pullë, i nënshtrohen procesit të konfiskimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve shkollore janë, si më poshtë vijon:

6.1 Nxënësit në arsimin bazë që:

- a) i përkasin kategorisë së pakicave kombëtare;
- b) janë fëmijë, i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.

6.2 Nxënësit në arsimin parauniversitar që:

- a) kanë përfutur statusin e jetimit;
- b) vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit;
- c) janë me aftësi të kufizuara, sipas ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- ç) vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paafte për punë, sipas ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- d) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti;
- dh) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura;

e) i përkasin kategorisë rome dhe egjiptiane. Drejtoritë përkatëse të institucioneve arsimore, ku mësojnë këta nxënës, duhet të dorëzojnë në ZVAP-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të këtyre kategorive. Mënyra e shpërndarjes së teksteve, për këto kategori nxënësish, përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin;

ë) gëzojnë statusin e të verbrit. Nxënësit pajisen me tekste shkollore të transkriptuara në shkrimin *brail*, të regjistruara në audio ose në shkrim të zmadhuar, të cilat janë pronë e shkollës. Administrimi i kërkesave për prodhimin/shumëfishimin e teksteve në *brail* dhe në shkrim të zmadhuar literal, si dhe pajisja me libra e nxënësve të verbër të realizohen nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë, në Tiranë. Drejtoritë përkatëse të institucioneve arsimore, ku mësojnë këta nxënës, duhet të dorëzojnë në ZVAP-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie;

f) janë viktimë të trafikimit, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme;

g) gëzojnë statusin e viktimës dhe të viktimës së mundshme të trafikimit, në përputhje me vendimin nr. 499, datë 29.8.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

gj) janë të moshës shkollore të arsimit parauniversitar, të cilët janë në institucionet e paraburgimit/vuajtjes së dënimit;

h) janë të shtruar në Shërbimin Onkologjik, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Kërkesa dhe sasia për tekstet shkollore dërgohet nga ky shërbim në muajin gusht të çdo viti;

i) janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

j) janë përfitues në institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës. Drejtoritë përkatëse të institucioneve arsimore, ku mësojnë këta nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të sipërpërmendura dhe të dorëzojnë në ZVAP-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

6.3 Nxënësit që ndjekin arsimin bazë, në klasën e parë, në institucionet arsimore publike, të cilëve u jepen tekstet shkollore të reja, çdo vit, në përdorim falas. Nxënësve, që ndjekin arsimin bazë në institucionet arsimore publike nga klasa e dytë deri në klasën e shtatë, u jepen tekstet shkollore në përdorim falas. Institucionet arsimore publike, si dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, brenda muajit korrik të çdo viti, përgatisin listën e parashikuar të teksteve për përdorim falas dhe të reja, nga klasa e parë deri në klasën e shtatë.

Blerja e teksteve të reja shkollore të nxënësve që ndjekin arsimin bazë, nga klasa e parë deri në klasën e shtatë, në institucionet arsimore publike, në emër të prindërve ose të përfaqësuesve ligjorë, për llogari të nxënësve, realizohet nga institucioni arsimor publik, për llogari të zyrës vendore të arsimit parauniversitar.

Likuidimi i faturës tatimore ndaj shtëpive botuese dhe/ose distributorëve realizohet nga zyra vendore e arsimit parauniversitar, me fondet e miratuara si “Transferte tek individët”, në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në llogarinë bankare të shitësit. Mënyra e shpërndarjes dhe e administrimit të teksteve, për këtë kategori nxënësish, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore për kategoritë e përcaktuara në këtë vendim mbulohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në formën e “Transfertës tek individët” dhe “Transfertës te shtëpitë botuese”, sipas rastit, në masën 100% të tij.

8. Shitja e teksteve shkollore bëhet përkundërt faturave. Për kategoritë e nxënësve, që përfitojnë sipas pikës 6 të këtij vendimi, pagesa bëhet nëpërmjet llogarive buxhetore të ZVAP-ve ose të vetë institucionit arsimor, kur ka llogari të tillë, me fondet e miratuara si “Transferte tek individët” në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

9. Procedurat e përdorimit dhe të shpërndarjes së fondeve buxhetore për blerjen e teksteve shkollore, si dhe mënyra e pagesës për kategorinë e nxënësve përfitues përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Vendimi nr. 107, datë 10.2.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**URDHËR NR. 46, DATË 16.3.2021 "PËR PËRZGJEDHJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E
TEKSTEVE SHKOLLORE TË KLASAVE 1, 2, 3, 4, 8,9, 10, 11, 12 TË SISTEMIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022"**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 1557/1 Prot.

Tiranë, më 16.3.2021

URDHËR

Nr. 46, datë 16.3.2021

PËR

**PËRZGJEDHJEN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE
TË KLASAVE 1, 2, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12 TË SISTEMIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Shqipërisë, nenit 47 të ligjit nr. 69/12, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 17.6.2020 "Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar", vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 227, datë 17.4.2019 "Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Katalogu i teksteve shkollore

- Nxënësit e klasave 1-12 të arsimit parauniversitar punojnë me tekstet shkollore, sipas katalogut, bashkëlidhur këtij Urdhri.
- Katalogu i teksteve shkollore të shpallet në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), www.arsimi.gov.al.

2. Përzgjedhja e teksteve shkollore

2.1 Përzgjedhja e teksteve nga mësuesit në bazë shkolle

- a) Për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së teksteve shkollore që do të përdorin nxënësit e klasave 1, 2, 3, 4, 8, 9, 10, 11, 12 të arsimit parauniversitar, mësuesit të grupohen në çdo shkollë në bazë të ekipeve lëndore.
- b) Procesi i përzgjedhjes së teksteve shkollore të administrohet nga Komisioni i Administrimit (KA), i përbërë nga tre anëtarë (kryetar, sekretar dhe një anëtar). Komisioni i Administrimit të zgjidhet me konsensus nga këshilli i mësuesve të shkollës.
- c) Planet mësimore me të njëjtën renditje të temave mësimore, për çdo lëndë dhe për çdo klasë, që u zbatuan në vitin shkollor 2020-2021 në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia COVID 19, nuk do të përdoren në vitin shkollor 2021-2022.

2.2 Detyrat e Komisionit të Administrimit

Komisioni i Administrimit ka për detyrë:

- a) Të njohë të gjithë mësuesit e shkollës me këtë Urdhër dhe katalogun bashkëlidhur.
- b) Të shpallë datën, orën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes për përzgjedhjen të teksteve shkollore.
- c) Të japë udhëzimet për të gjitha procedurat që do të ndiqen nga mësuesit.
- d) Të administrojë procesverbalet e mësuesve të ekipeve lëndore.
- e) Të hartojë, mbi bazën e procesverbaleve të mësuesve, tabelën përmbledhëse të teksteve shkollore për çdo botues/distributor, titujt e të cilit janë përzgjedhur nga mësuesit. Tabelat përmbledhëse të hartohen në tri kopje origjinale dhe të nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e KA-së.

2.3 Detyrat e mësuesve të klasave dhe të ekipeve lëndore

- a) Mësuesit e klasave dhe të ekipeve lëndore të njihen me të gjitha alternativat e teksteve shkollore të përfshira në katalog dhe pas diskutimeve për to, të vendosin për tekstin që do të përdoret në secilën klasë/lëndë.
- b) Përzgjedhja e tekstit të bëhet me konsensus. Në rast se mësuesit e klasave ose të ekipeve lëndore nuk bien dakord, përzgjedhja të bëhet me votim. Fitues është teksti që merr shumicën e votave.
- c) Në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore të ftohen për të qenë të pranishëm prindërit e nxënësve. Prindërit vëzhgojnë procedurat e përzgjedhjes, por nuk marrin pjesë në votim.
- d) Mbledhja e mësuesve të klasave dhe e ekipeve lëndore për përzgjedhjen e teksteve të bëhet e hapur për prindërit dhe median. Në përfundim, mësuesit e klasave dhe ata të ekipeve lëndore të plotësojnë dhe të nënshkruajnë procesverbalet e përzgjedhjes së teksteve. Në këto procesverbale të pasqyrohet detyrimisht dhe saktë titulli/titujt e përzgjedhur, botuesi/distributori përkatës dhe sasia që do të porositet. Procesverbalet t'i dorëzohen KA-së.

- e) Procesi i përzgjedhjes së teksteve shkollore të fillojë më 29 mars 2021 dhe të përfundojë më 2 prill 2021 dhe të zhvillohet duke respektuar protokollet e sigurisë në kuadër të situatës pandemike.

2.4. Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të shkollës

- a) Drejtori i shkollës ka përgjegjësinë të njohë këshillin e mësuesve të shkollës me përmbajtjen e këtij Urdhri; të sigurojë katalogun bashkëlidhur këtij Urdhri, dhe t'i njohë të gjithë mësuesit e shkollës me të; të miradministrojë të gjithë dokumentacionin që rrjedh nga zbatimi i këtij Urdhri, përfshirë edhe kopjet e teksteve shkollore të dërguara/të dorëzuara nga botuesit/distributorët; të inventarizojë detyrimisht në bibliotekën e shkollës kopjet e teksteve shkollore të dërguara/të dorëzuara nga botuesit/distributorët.
- b) Drejtori i shkollës ka detyrimin t'i përcjellë zyrtarisht çdo botuesi/distributori një kopje origjinale të tabelës përmbledhëse përkatëse, të hartuar dhe të nënshkruar nga KA-ja, brenda datës 8 prill 2021. Ai mban përgjegjësi për sasinë e teksteve shkollore të porositura te botuesit/distributorët për klasë/lëndë, në mënyrë që sasia e kërkuar, plotësojë të gjitha nevojat e nxënësve për tekste shkollore.
- c) Drejtori i shkollës ka detyrimin të dërgojë në institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, brenda datës 14 prill 2021, tabelën përmbledhëse me titujt dhe sasinë e teksteve të përzgjedhura nga shkolla.
- d) Institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar, që kanë në varësi shkolla të pakicave kombëtare, për tekstet në gjuhën amtare të pakicave kombëtare zbatojnë vendimin e Këshillit të Ministrave nr.227, datë 17.4.2019 "Për përgatitjen, shtypjen, botimin dhe shpërndarjen e teksteve shkollore të arsimit bazë për nxënësit e institucioneve arsimore publike parauniversitare, ku mësojnë nxënës të pakicave kombëtare".
- e) Dokumentacioni që rrjedh nga zbatimi i këtij Urdhri, të ruhet në arkivin e shkollës për dy vite kalendarike. Ai të jetë objekt i kontrollit të MASR-së dhe strukturave të saj.

3. Detyrat e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar

Institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar ka për detyrë:

- a) Të njohë me këtë Urdhër të gjitha drejtoritë e shkollave në varësi.
- b) Të sigurojë për të gjitha drejtoritë e shkollave në varësi katalogun bashkëlidhur këtij Urdhri, në formën elektronike dhe të shtypur.
- c) Të hartojë, mbi bazën e të dhënave të marra nga shkollat e varësisë, tabelën përmbledhëse të teksteve shkollore të përzgjedhura në shkallë institucioni përgjegjës për arsimin parauniversitar. Kjo tabelë plotësohet detyrimisht sipas formatit të kërkuar nga MASR-ja dhe dërgohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP) brenda datës 19 prill 2021. DPAP dërgon tabelën përmbledhëse në MASR brenda datës 23 prill 2021.

4. Monitorimi i procesit të përzgjedhjes, porosisë, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore

- a) MASR-ja, strukturat e saj përgjegjëse dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar të monitorojnë mbarëvajtjen e procesit të përzgjedhjes dhe porosisë së teksteve shkollore, në përputhje me këtë Urdhër.

5. Konflikti i interesit

- a) Çdo punonjësi të MASR-së dhe të institucioneve të varësisë i ndalohet ndikimi, në çfarë do lloj forme, në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore.
- b) Tekstet shkollore që kanë autorë, redaktorë, korrektorë, ilustrues etj., që janë mësues ose drejtues të shkollave, nuk mund të përzgjidhen në shkollat në të cilat ata punojnë.
- c) Titullari i institucionit arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar, çdo punonjës i tij dhe drejtuesit e shkollave e kanë të ndaluar të bëjnë presion të rekomandojë apo të ndikojnë në çfarëdolloj forme apo mënyre të mësuesit, në përzgjedhjen e teksteve shkollore. Atyre nuk u lejohet favorizimi i botuesve/distributorëve apo i autorëve të veçantë, si dhe dallimi i teksteve të veçanta në raport me të tjerat. Në rast të verifikimit të shkeljeve të sipërpërmendura, personat përgjegjës penalizohen deri në largim nga detyra.
- b) Gjatë procesit të përzgjedhjes së teksteve në shkolla nuk lejohet asnjë veprimtari e botuesve/distributorëve, që ka për qëllim publicitetin e teksteve të tyre.

6. Shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore

- a) Botuesit dhe distributorët përkatës janë përgjegjës për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore. Ata duhet ta përfundojnë shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore detyrimisht një javë para fillimit të vitit shkollor.
- b) Botuesit/distributorët që shesin tekste shkollore pa pullën me hologramë, apo me çmime të ndryshme nga ato të katalogut bashkëlidhur këtij Urdhri, skualifikohen.
- c) Shitja e teksteve shkollore të bëhet nëpërmjet njësite tregtare të shitjes së librave ose në pika të tjera shitjeje pranë shkollave, nga subjekte të licencuara. Me kërkesën e botuesve apo distributorëve, drejtoritë e shkollave janë të detyruara të vënë në dispozicion falas një ose dy mjedise për shitjen e teksteve shkollore. Tekstet që shiten, duhet të kenë detyrimisht pullën me hologramën e MASR-së.
- d) Ndalohet shpërndarja dhe shitja e teksteve shkollore nga punonjës arsimorë, me përjashtim të teksteve për nxënësit e pakicave kombëtare. Shpërndarja dhe shitja për këtë kategori nxënësish mund të bëhet nga punonjës arsimorë të ngarkuar nga institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e shkollave përkatëse.
- e) Institucioni arsimor vendor përgjegjës për arsimin parauniversitar cakton një person përgjegjës (pikë kontakti), në nivel përgjegjës sektori që mban lidhje të vazhdueshme me DPAP-në për të informuar në vazhdimësi për mbarëvajtjen e procesit.
- f) Drejtoria e shkollës, në javën e fundit të vitit shkollor, publikon në vendin më të

dukshëm për nxënësit dhe prindërit, listën e teksteve shkollore që do të përdorë shkolla vitin e ardhshëm shkollor, emrin e botuesit/distributorit dhe çmimin e shitjes me pakicë.

- g) Subjekteve të licencuara për shitjen e teksteve shkollore nuk u lejoheq që, bashkë me tekstet shkollore me hologramën e MASR-së, t'u shesin nxënësve tekste që nuk i përkasin katalogut.
- h) Institucionet përgjegjëse për arsimin parauniversitar, gjatë dy javëve para fillimit të vitit të ri shkollor dhe një javë pas tij, të raportojnë elektronikisht çdo ditë në DPAP për pajisjen e nxënësve me tekste shkollore dhe DPAP raporton në MASR.
- i) Strukturat përgjegjëse për inspektim, institucionet arsimore vendore përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtuesit e shkollave, monitorojnë dhe raportojnë për shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore në periudhën qershor-shtator.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë të Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, institucionet arsimore parauniversitare dhe mësuesit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

EVIS KUSHI



KATALOGU I TEKSTEVE, VITI SHKOLLOR 2021 - 2022

BAZUAR NE ÇMIMET E TEKSTEVE SHKOLLORE TE KATALOGUT, PER VITIN 2020-2021, indeksuar me koofiç. e inflac. + 1.6 %, INSTAT.

Klasa & Titulli	Botuesi/Distributori	Botuesi i huaj	Autori / Autorët	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin (jo më i lartë, pa TVSh) për V.2019-2020	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin (jo më i lartë, pa TVSh) për V.2020-2021	Çmimi i shitjes me pakicë për nxënësin (jo më i lartë, pa TVSh) për V.2021-2022
1	2	3	4	5	6	7

GJIMNAZI						
Klasa 10						
Gjuhë shqipe	Filara		Valbona Kalo	510	521	530
			Migena Kapllani			
			Marsela Neni			
			Merita Balliçi			

Gjuhë shqipe	Albas	Rita Petro	329	336	342
		Aljula Jubani			
		Linda Mëniku			
Gjuhë shqipe	Mediaprint	Enkeleida Kapia	510	521	530
		Undita Murthi			
Letërsi	Albas	Sabri Hamiti	446	456	463
		Dhurata Shehri			
		Ardian Marashi			
Letërsi	Filara	Valbona Kalo	530	542	550
		Migena Kapllani			
		Marsela Neni			
		Merita Ballçi			
Letërsi	Botime Pegi	Ymer Çiraku	530	542	550
		Adriatike Lami			
		Edlira Tonuzi			
		Irena Lama			
		Arta Sulo			
Qytetari	Albas	Saemira Pino	297	304	308
		Elijana Brahja (Dosti)			
		Sidita Gjipali			
		Mirela Selita			
Qytetari	Erik	Anila Tabaku	307	314	319
		Najada Hoxha			
Qytetari	Botime Pegi	Klodiana Beshku	506	517	525
		Oltion Spiro			
		Brunilda Zenelaga			
		Gentiana Qirjako			
Histori	Ideart	Uambro Filo	424	433	440
		Mamica Thanati			
Histori	Albas	Tomi Treska	446	456	463
		Dritan Egro			
		Menduh Dërguti			
Histori	Botime Pegi	Romeo Gurakuqi	467	477	485
		Paulina Hoxha			

			Anila Beshaj			
			Petrika Thëngjilli			
			Andi Pinarl			
Gjeografi	Ideart		Vasil Kristo	396	405	411
			Skënder Sala			
Gjeografi	Filara		Fatmiroshe Xhemalaj	396	405	411
			Romeo Hanxhari			
			Arben Belba			
Gjeografi	Albas		Reinhard Herzig	340	347	353
			Diana Manaj			
Arte. Teatër	Botime Pegi		Mehmet Xhelili	292	298	303
Arte. Teatër	Albas		Alfred Trebicka	234	239	243
			Ramiz Zalla			
Arte. Teatër	Erik		Josif Papagjoni	271	277	281
Arte. Muzikë	Albas		Irisha (Irimi) Gaqi	234	239	243
Arte. Muzikë	Botime Pegi		Valbona Dura	290	296	301
Arte. Muzikë	Erik		Zana Shuteriqi (Prela)	266	272	276
Arte. Art pamor	Botime Pegi		Silvana Nini	292	298	303
			Ermir Hoxha			
Arte. Art pamor	Erik		Zef Paci	271	277	281
			Ferid Hudhri			
Arte. Art pamor	Albas		Edmond Gjokopulli	234	239	243
TIK	Botime Pegi		Ada Gogu	414	423	430
			Altina Myderizi			
TIK	Irisoft Education		Silvana Greca	403	412	418
			Krudi Ramilli			
			Esmeralda Tasho			
TIK	Ideart		Ilia Ninka	414	423	430
			Etleva Smaçi			
Focus2 B1+ student's book	Uegen	Pearson	Sue Kay	729	745	757
(Gjuhë angleze e parë Libri i nxënësit)			Vaughan Jones			
			Daniel Brayshaw			
			Bartosz Michalowski			
Focus B1+ workbook	Uegen	Pearson	Daniel Brayshaw	510	521	530

(Gjuhë angleze e parë Fletore pune)			Bartosz Michalowski			
On Screen B1+ Student's Book	SIDI Group	Express Publishing	Virginia Evans	690	705	716
(Gjuhë angleze e parë Libri i nxënësit)			Jenny Dooley			
On Screen B1+ Workbook & Grammar Book	SIDI Group	Express Publishing	Virginia Evans	583	596	605
(Gjuhë angleze e parë Fletore pune)			Jenny Dooley			
Close up B1	CLME	Cengage Learning	Angela Healan	742	758	770
(Gjuhë angleze e parë Libri i nxënësit)		EMEA Limited	Katrina Gormley			
Close up B1	CLME	Cengage Learning		669	684	695
(Gjuhë angleze e parë Fletore pune)		EMEA Limited				
Jetstream beginner	CLME	Helbling Language	Amanda Maris	797	815	828
(Gjuhë angleze e dytë)		GmbH				
Jetstream beginner Workbook	CLME	Helbling Language	Amanda Maris	383	391	398
(Gjuhë angleze e dytë Fletore pune)		GmbH	Jane Revell			
Vision A1+ Student's book	SIDI Group	Express Publishing	Virginia Evans	797	815	828
(Gjuhë angleze e dytë Libri i nxënësit)			Jenny Dooley			
Vision A1+ Workbook & Grammar book	SIDI Group	Express Publishing	Virginia Evans	380	388	395
(Gjuhë angleze e dytë Fletore pune)			Jenny Dooley			
New Inspiration Student's Book 1	SIDI Group	Macmillan	Judy Garton-Sprenger	797	815	828
(Gjuhë angleze e dytë Libri i nxënësit)			Philip Prowse			
New Inspiration Workbook 1	SIDI Group	Macmillan	Judy Garton-Sprenger	380	388	395
(Gjuhë angleze e dytë Fletore pune)			Philip Prowse			
			Helena Gorn			
Saison 3 B1 Livre	SIDI Group	Groupe Hatier	M. Corton	868	887	901
(Gjuhë frënge e parë Libri i nxënësit)		International	I. Cros			
			D. Duplex			
			C. Mraz			
			D. Ripaud			
Saison 3 B1 Cahier d'activités	SIDI Group	Groupe Hatier	Marion Alcaraz	563	575	585
(Gjuhë frënge e parë Fletore pune)		International	Fabienne Beduchaud			
			Celine Braud			
			Aurelien Calvez			
			Camille Dereeper			

			Emilie Pommier			
			Delphine Ripaud			
Agenda 3 B1.1 Livre de l'eleve	SIDI Group	Hachette	Murielle Bidault	868	887	901
(Gjuhë frënge e parë Libri i nxënësit)			Gabrielle Chort			
			Fanny Kablan			
			Frederique Treffandier			
Agenda 3 B1.1 Cahier d'activites	SIDI Group	Hachette	Audrey Gloanec	563	575	585
(Gjuhë frënge e parë Fletore pune)						
Generation A1 - Methode de française	SIDI Group	Groupe Hatier	P. Dauda	1068	1091	1109
Livre + Cahier		International	L. Giachino			
(Gjuhë frënge e dytë Libri i nxënësit +			C. Baracco			
Fletore pune)			M. Chaneschi			
			D. Cecchi			
			F. Tortelli			
Le nouveau taxi 1 A1 Livre de l'eleve	SIDI Group	Hachette	Guy Capelle	865	884	898
(Gjuhë frënge e dytë Libri i nxënësit)			Robert Menand			
Le nouveau taxi 1 A1 Cahier d'exercices	SIDI Group	Hachette	Guy Capelle	530	542	550
(Gjuhë frënge e dytë Fletore pune)			Robert Menand			
Caffe Italia 2 Corso di italiano	SIDI Group	Eli SRL	Nazzarena Cozzi	1169	1195	1214
Libro dello studente con esercizi			Francesco Federico			
(Gjuhë italiane e parë Libri i nxënësit			Adriana Tanconre			
dhe Fletore pune)						
Allegro 2 Corso Multimediale d'italiano	SIDI Group	Edilingua	Linda Toffolo	1169	1195	1214
Libro dello studente ed esercizi			Maria Gloria Tommasini			
(Gjuhë italiane e parë Libri i nxënësit			Renate Merklingshaus			
dhe Fletore pune)						
Caffe Italia 1 Corso di italiano -	SIDI Group	Eli SRL	Nazzarena Cozzi	1169	1195	1214
Libro dello studente con esercizi			Francesco Federico			
(Gjuhë italiane e dytë Libri i nxënësit			Adriana Tanconre			
dhe Fletore pune)						
Allegro 1 Corso Multimediale d'italiano	SIDI Group	Edilingua	Linda Toffolo	1169	1195	1214
Libro dello studente ed esercizi			Nadia Nuti			
(Gjuhë italiane e dytë Libri i nxënësit			Renate Merklingshaus			
dhe Fletore pune)						

Aspekte neu intensivtrainer B1+	SIDI Group	Klett-Langenscheid	Marion Lutke	1008	1030	1047
(Gjuhë gjermane e parë Libri i nxënësit)		GmbH				
Aspekte neu lehrbuch B1+	SIDI Group	Klett-Langenscheid	Ute Koithan	583	596	605
(Gjuhë gjermane e parë Fletore pune)		GmbH	Helen Schmitz			
			Tanja Sieber			
			Rafi Sonntag			
Sicher B1+	CLME	Hueber	Michaela Perlmann-Balme	1040	1063	1080
(Gjuhë gjermane e parë Libri i nxënësit)			Susanne Schwalb			
Sicher B1+	CLME	Hueber	Michaela Perlmann-Balme	826	844	858
(Gjuhë gjermane e parë Fletore pune)			Susanne Schwalb			
Genial klick kursbuch A1	SIDI Group	Klett-Langenscheid	Michael Koening	1008	1030	1047
(Gjuhë gjermane e dytë Libri i nxënësit)		GmbH	Ute Koithan			
			Theo Scherling			
Genial klick intensivtrainer A1	SIDI Group	Klett-Langenscheid	Maruska Mariotta	583	596	605
(Gjuhë gjermane e dytë Fletore pune)		GmbH	Petra Pfeilhofer			
Menschen A1.1	CLME	Hueber	Sandra Evans	1040	1063	1080
(Gjuhë gjermane e dytë Libri i nxënësit)			Angela Pude			
			Franz Specht			
Menschen A1.1	CLME	Hueber	Sandra Evans	826	844	858
(Gjuhë gjermane e dytë Fletore pune)			Angela Pude			
			Franz Specht			
Klasa 10 - 11						
Matematikë 10 - 11, libri i nxënësit	Mediaprint	Pearson	Naomi Norman	626	640	650
pjesa I			Katherine Pate			
Matematikë 10 - 11, libri i nxënësit	Mediaprint	Pearson	Naomi Norman	629	643	653
pjesa II			Katherine Pate			
Matematikë 10 - 11, fletore pune	Mediaprint	Pearson	Navtej Marwaha	266	272	276
Matematikë 10 - 11, libri i nxënësit	Albas	Cambridge	Karen Morrison	626	640	650
pjesa I			Julia Smith			
			Pauline McLean			
			Rachael Horsman			
			Nick Asker			
Matematikë 10 - 11, libri i nxënësit	Albas	Cambridge	Karen Morrison	629	643	653

pjesa II			Julia Smith			
			Pauline McLean			
			Rachael Horsman			
			Nick Asker			
Matematikë 10 - 11, libri i nxënësit	Botime Pegi	Oxford	Steve Fearnley	530	542	550
pjesa I			Jane Haighton			
			Steve Lomax			
			Peter Mullarkey			
			James Nicholson			
			Matt Nixon			
Matematikë 10 - 11, libri i nxënësit	Botime Pegi	Oxford	Steve Fearnley	530	542	550
pjesa II			Jane Haighton			
			Steve Lomax			
			Peter Mullarkey			
			James Nicholson			
			Matt Nixon			
Matematikë 10 - 11, fletore pune	Botime Pegi	Oxford		266	272	276
Fizikë 10 - 11, libri i nxënësit, pjesa I	Erik	Oxford	Stephen Pople	287	293	298
Fizikë 10 - 11, libri i nxënësit, pjesa II	Erik	Oxford	Stephen Pople	302	309	314
Fizikë 10 - 11, fletore pune	Erik	Oxford	Sarah Lloyd	276	282	287
Fizikë 10 - 11, pjesa I	Dudaj Group	Pearson	Brian Arnold	414	423	430
			Steve Woolley			
			Penny Johnson			
Fizikë 10 - 11, pjesa II	Dudaj Group	Pearson	Brian Arnold	419	428	435
			Steve Woolley			
			Penny Johnson			
Fizikë 10 - 11, libri i nxënësit, pjesa I	Mediaprint	Cambridge	David Sang	414	423	430
Fizikë 10 - 11, libri i nxënësit, pjesa II	Mediaprint	Cambridge	David Sang	419	428	435
Fizikë 10 - 11, fletore pune	Mediaprint	Cambridge	David Sang	266	272	276
Biologji 10 - 11, pjesa I	Dudaj Group	Pearson	Mary Jones	456	466	473
Biologji 10 - 11, pjesa II	Dudaj Group	Pearson	Mary Jones	463	473	481
Biologji 10 - 11, libri i nxënësit, pjesa I	Mediaprint	Oxford	Ron Pickering	424	433	440
Biologji 10 - 11, libri i nxënësit, pjesa II	Mediaprint	Oxford	Ron Pickering	424	433	440
Biologji 10 - 11, fletore pune	Mediaprint	Oxford	Ron Pickering	266	272	276

Biologji 10 - 11, pjesa I	Botime Pegi	Cambridge	Mary Jones	424	433	440
			Geoff Jones			
Biologji 10 - 11, pjesa II	Botime Pegi	Cambridge	Mary Jones	424	433	440
			Geoff Jones			
Kimi 10 - 11 Pjesa I	Dudaj Group	Pearson	Andrew Clegg	456	466	473
Kimi 10 - 11 Pjesa II	Dudaj Group	Pearson	Andrew Clegg	464	474	482
Kimi 10 - 11, libri i nxënësit, pjesa I	Mediaprint	Cambridge	Richard Harwood	424	433	440
			Ian Lodge			
Kimi 10 - 11, libri i nxënësit, pjesa II	Mediaprint	Cambridge	Richard Harwood	424	433	440
			Ian Lodge			
Kimi 10 - 11, fletore pune	Mediaprint	Cambridge	Richard Harwood	266	272	276
			Ian Lodge			
Kimi 10 - 11, pjesa I	Botime Pegi	Oxford	RoseMarie Gallagher	424	433	440
			Paul Ingram			
Kimi 10 - 11, pjesa II	Botime Pegi	Oxford	RoseMarie Gallagher	424	433	440
Tekste shkollore digjitale						
Matematikë 10	Botime Pegi			530	542	550
Matematikë 10	Albas			626	640	650
Fizikë 10	Albas			414	423	430
Biologji 10	Botime Pegi			424	433	440
Biologji 10	Albas			424	433	440
Kimi 10	Botime Pegi			424	433	440
Kimi 10	Albas			424	433	440
Letërsi 10	Botime Pegi			530	542	550
